

VENDIM
Nr. 721, datë 11.11.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT, SHUMËS VJETORE TË
TRANSFERTËS NGA BUXHETI I SHTETIT DHE PROCEDURAVE TË
FINANCIMIT TË FONDIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE PËR TRAJTIMIN
FINANCIAR SUPLEMENTAR TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË
MINIERA NË NËNTOKË, TË PUNONJËSVE TË INDUSTRIKËS SË NAFTËS E TË
GAZIT DHE TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË METALURGJI**
(Ndryshuar me vendimin nr. 276, datë 29.4.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 13, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të përfutur pension për shkak të profesionit, personat që plotësojnë kushtet sipas ligjit, plotësojnë kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” dhe dërgojnë nëpërmjet shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin, dokumentet shoqëruese, si më poshtë vijon:

- a) Librezën e punës të plotësuar në të gjitha rubrikat, sipas llojit të punës;
- b) Vërtetimin për bazën e vlerësuar për periudhat e punësimit nga data 1.1.1994 deri në datën e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare nga puna ose vetëpunësimi;
- c) Vërtetimin e posaçëm të konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në vendimin nr.526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, i lëshuar nga ndërmarrja ku personi ka qenë i punësuar, kur subjekti është aktiv ose nga dokumentacioni arkivor i sigurimeve shoqërore;
- ç) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton llojin dhe periudhën e punës për efekt pensioni, i njohur për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Për të përfutur shtesë mbi pensionin, sipas nenit 4, të ligjit nr.29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, personat që plotësojnë kushtet e neneve 3 e 6, të këtij ligji, dhe janë përfutur të pensionit sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, “Mbi sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pensionit të parakohshëm, sipas nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, si dhe sipas ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, kur data e lindjes të së drejtës për pension është deri më 31.12.2014, plotësojnë kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania” dhe dërgojnë nëpërmjet shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku kanë vendbanimin, çdo dokumentacion tjetër që vërteton llojin dhe periudhën e punës, për efekt pensioni, i njohur për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore vendos në dispozicion të kërkuësve, brenda 10 (dhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, formatin e kërkesës për përfitim të pensionit për shkak të profesionit dhe për përfitim të shtesës mbi pensionin, si dhe formatin e vërtetimit të posaçëm të konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira.

4. Në rastet kur subjektet punëdhënëse nuk janë aktive ose janë të mbyllura, dokumentacioni vërtetues i llojit të punës dhe kohëzgjatjes së saj, si dhe baza e vlerësuar për efekt të kalkulimit të

pensionit plotësohen nga strukturat përgjegjëse të sigurimeve shoqërore dhe bashkohen në dokumentacionin e dosjes së përfitimit, duke ia bërë të njohur edhe personit kërkuar.

5. Në zbatim të nenit 8, të ligjit të nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, shuma e transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurat e financimit të fondit të sigurimeve shoqërore realizohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të shtetit.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bazuar në numrin e kontribuesve të këtyre industrive dhe normës kontributive të caktuar me ligj, parashikon të ardhurat nga kontributet. Bazuar në numrin e përfituesve, masën mesatare të përfitimit, shtesën e numrit të përfituesve të rinj dhe pakësimit të përfituesve nga daljet në pension pleqërie llogariten shpenzimet e nevojshme.

Diferenca mes shpenzimeve dhe të ardhurave parashikohet për t’u përballuar nga buxheti i shtetit në vitin përkatës. Kjo miratohet nga Këshilli i Ministrave si pjesë e buxhetit të sigurimeve shoqërore në buxhetin e shtetit.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 29, datë 23.5.2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, dhe i këtij vendimi, për vitin 2019, llogariten në shumën 725 000 000 (shtatëqind e njëzet e pesë milionë) lekë dhe përballohen nga fondet e programuara në buxhetin e sigurimeve shoqërore të vitit 2019.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 5 korrik 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama